



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Gjykimi në çështjen gjyqësore *Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi* rifilloi të hënën, më 25 shtator, me dhënien e dëshmisë së dëshmitarit të 26-të i thirrur nga Prokuroria. Sipas përmbledhjes së shkurtër të lexuar në sallë të gjyqit, dëshmitari dhe anëtarët e familjes së tij u mbajtën të ndaluar nga anëtarë të UÇK-së më 1998, ku pas kësaj disa nga anëtarë të familjes së tij u vranë. Dëshmitari dëshmoi me masa mbrojtëse, me ndryshim të zërit dhe të fytyrës, dhe u mor në pyetje nga Prokuroria, Mbrojtësi i Viktimave dhe Mbrojtja.

Të martën, dëshmitari i 27-të i thirrur nga Prokuroria filloi dhënien e dëshmisë, e cila vazhdoi të mërkurën dhe seanca ishte plotësisht e mbyllur. Gjykimi u mbyll dje për këtë javë, dhe seancat do të vazhdojnë më 9 tetor.

Më 21 shtator, Trupi Gjykes në të njëjtën çështje gjyqësore miratoi kërkesën e Mbrojtjes së Selimit që të lëshohet versioni konfidencial me më pak redaktime i vendimit të konfirmimit të aktakuzës për të pasqyruar versionet e disponueshme me më pak redaktime të aktakuzës dhe dosjes paraprake të ZPS-së.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, dëshmitari i parë i thirrur nga Mbrojtja, z. Bardhyl Mahmuti, përfundoi dhënien e dëshmisë të enjten e kaluar. Seancat në çështjen *Shala* do të vazhdojnë të hënën, më 2 tetor, në orën 9:30, dhe janë planifikuar të vazhdojnë tërë javën.

Në lajme të tjera, ekipi për komunikim dhe ndërgjegjësim i Dhomave të Specializuara të Kosovës vizitoi Kosovën javën e kaluar, ku u takuan me studentë të drejtësisë dhe shoqërinë civile në Prishtinë dhe Vërboc. Që nga 2018, ekipi për komunikim dhe ndërgjegjësim është takuar me mbi 3.300 njerëz gjithandej Kosovës, duke ofruar informacion për gjykatën, duke dëgjuar mendimet e njerëzve dhe duke iu përgjigjur pyetjeve të tyre.

Më 24 shtator, Dhomat e Specializuara të Kosovës morën pjesë në Ditën e Vizitave *Vetëm Paqe* në Hagë, me ç'rast hapën dyert për publikun e interesuar që vizituan gjykatën, dëgjuan prezantimin lidhur me mandatin dhe proceset gjyqësore të DHSK-së dhe bënë pyetje.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

